



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.348/28 prot.

Datë 16.06.2025

**V E N D I M**

**Nr. 776/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Fiorent Zguro  | Nënkryetar |
| Anila Malaj    | Anëtar     |
| Gjergj Mersini | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 16.06.2025 mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-34934-12-30-2024, me objekt: Supervizion punimesh për objektin: “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”, me fond limit 6,289,100.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK me NIPT (L51825011V) dhe adresë: “Rruga e Kavajës”, ish-Parku, pranë Tregut “100 Vitrinat”, Kulla C, Shkalla 2.

**Autoriteti Kontraktor:**

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 4, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 31.12.2024, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-34934-12-30-2024 me objekt: “Supervizion punimesh për objektin: “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”, me fond limit 6,289,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 10-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

II.2. Në datën 17.01.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                                     |              |              |
|-------------------------------------|--------------|--------------|
| 1.G B Civil Engineering             | 5,470,432.88 | Skualifikuar |
| 2.BOE “Bersant Ylli” & “XH & MILER” | 5,470,432.90 | Skualifikuar |
| 3.HYDRO-ENG CONSULTING              | 5,470,432.9  | Skualifikuar |
| 4.HTS COMPANY                       | 5,489,199.51 | Skualifikuar |
| 6.NET-GROUP                         | 5,502,962.50 | Skualifikuar |
| 7.BOE “ZETAKONSULT” & “DERBI-E”     | 5,502,962.50 | Skualifikuar |
| 8.BOE “TAULANT”& ”NOOR ENGINEERING” | 5,502,962.51 | Skualifikuar |
| 9.NOVATECH STUDIO                   | 5,502,962.81 | Skualifikuar |
| 10.BOE “STATENG” & ”MCE”            | 5,507,609.59 | Skualifikuar |
| 11.Gjeokonsult & CO                 | 5,507,609.59 | Skualifikuar |
| 12.C.E.C GROUP                      | 5,529,202.47 | Kualifikuar  |
| 13.A & E ENGINEERING”               | 5,622,250.00 | Kualifikuar  |

II.4. Në datën 03.02.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 05.02.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5024, si dhe nr. protokolli 348/2025, datë 05.02.2025, i operatorit ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 348/1, datë 06.02.2025.

II.7. Me shkresat nr. 348/2 prot, datë 24.02.2025 dhe nr. 348/3 prot, datë 06.03.2025 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK” dhe “Ridërgohet kërkesa

*për informacion*”, janë përcjellë tek autoriteti kontraktor kërkesat për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.5. Me shkresën nr.564/1 prot., datë 07.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/4 prot., datë 10.03.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën me objekt “Kthim përgjigje”, nëpërmjet të cilës informon se nga verifikimi i sistemit mbi paraqitjen e ankesës nga ky operator ekonomik nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë ankesë e publikuar në sistem si dhe në llogarinë e AK, duke e bashkëlidhur me screen të llogarisë së AK mbi ankesat që i rezultojnë të paraqitura në sistem.

I.6. Me shkresën nr.348/5 prot., datë 19.03.2025, është përcjellë te autoriteti kontraktor nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik përsëri kërkesa për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “GB Civil Engineering” SHPK, pasi pas verifikimit dhe kontrollit të bërë nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik ankesa e sipërcituar rezulton e shfaqur rregullisht në sistemin e prokurimeve publike.

I.7. Me shkresën nr.781/1 prot., datë 21.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/6 prot., datë 02.04.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën me objekt “Kthim përgjigje”, nëpërmjet të cilës informon se nga verifikimi i sistemit pas shkresës së dërguar nga KPP dhe postës elektronike [kpp\\_info@kpp.gov.al](mailto:kpp_info@kpp.gov.al), ankesa e paraqitur shfaqet në sistem, por përsëri kjo ankesë nga ky operator ekonomik nuk rezultonte të jetë e shfaqur sipas screen-it të bërë nga AK datë 07.03.2025.

I.8. Me shkresën nr.781/2 prot., datë 28.03.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/7 prot., datë 09.04.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën me objekt “Kërkesë për asistencë”, nëpërmjet të cilës informon se ndodhur në kushtet në të cilat Autoriteti Kontraktor ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës, duke publikuar njoftimin e fituesit përfundimtar për këtë procedurë prokurimi dhe nuk ka mundësi trajtimi të ankesës së publikuar më vonë në sistem siç ju kemi parashtruar si më lart, lutemi të na njoftoni si të vijnë me hapat e mëtejshëm për këtë procedurë prokurimi.

I.9. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, vendos të thërrasë ekspertin e fushës për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

I.10. Eksperti zgjidhet nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik,

I.11. Eksperti i parë në rend alfabetik i cili referuar dokumentacionit zotëronte kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës ishte Eksperti Bujar Bundo, i cili do të asistonte Komisionin e Prokurimit Publik në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi. Në datën 07.04.2024 u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, eksperti Bujar Bundo. Pas paraqitjes së tij në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik nuk u dakortësua asistenca e tij në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi sipas procesverbalit të datës 08.04.2025.

I.12. Eksperti i dytë në rend alfabetik i cili referuar dokumentacionit zotëronte kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës ishte Eksperti Elidon Kallaverja, i cili do të asistonte Komisionin e Prokurimit Publik në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi.

I.13. Në datën 08.04.2025 u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, eksperti Elidon Kallaverja. Eksperti pranon, se është i specializuar për përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim si dhe përcaktoi tarifën prej 50.000 lekë për kryerjen e ekspertizës. Pas paraqitjes së tij në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u dakortësua asistenca e tij në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi, sipas procesverbalit të datës 09.04.2025. Gjithashtu Eksperti pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 14 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit.

II.14. Në datë 09.04.2025 Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin e ndërmjetëm nr. 457/2025, në të cilin u vendos:

1. *“Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-34934-12-30-2024, me objekt: Supervizion punimesh për objektin: “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”, me fond limit 6,289,100.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.*
2. *Operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK të parapaguajë për llogari të z. Elidon Kallaverja shumën prej 50,000 lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 14.04.2025 ora 11:00.*
3. *Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 16.04.2025.*
4. *Në datën 17.04.2025 ora 11:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik eksperti z. Elidon Kallaverja për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës, si dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.*
5. *Eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 28.04.2025.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.15. Me shkresën e datës 14.04.2025, protokolluar me tonën me nr.348/11 prot., datë 14.04.2025, operatori ekonomik ankimues ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës, argumentim si dhe mandatpagesën, e cila vërteton kryerjen e pagesës në llogarinë e ekspertit Elidon Kallaverja, në zbatim të vendimit nr. 457/2025 datë 09.04.2025 të KPP-së.

II.16. Me shkresat nr.348/12 prot, datë 18.04.2025, nr.348/13 prot, datë 30.04.2025, nr.348/14 prot, datë 09.05.2025, nr.348/15 prot, datë 19.05.2025, Komisioni i është drejtuar autoritetit kontraktor për efekt të shqyrtimit të ankesës, duke kërkuar informacion të detajuar mbi procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit të projektit të zbatimit me objekt *“Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”*, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka përllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit me objekt: Supervizion punimesh për objektin: *“Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”*.

II.17. Me shkresën nr.564/4 prot., datë 14.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/16 prot., datë 22.05.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën me objekt *“Kthim përgjigje”*, nëpërmjet të cilës konstatohet informacioni i kërkuar mbi përllogaritjen e fondit limit të projektit të zbatimit me objekt *“Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”*, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka përllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit me objekt: Supervizion punimesh për objektin: *“Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”*.

II.18. Me shkresën nr. 348/17 prot., datë 23.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertit Elidon Kallaverja, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e tij, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertit i janë parashtruar këto pyetje:

- 1. A është përllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
- 2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat” me fond limit 937,788,493.28 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*

II.19. Në zbatim të vendimit nr. 457/2025 datë 09.04.2025 të KPP-së, me shkresën e datës 28.05.2025, me objekt *“Raport paraprak”* protokolluar me tonën me nr. 348/18 prot., datë 29.05.2025, eksperti ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin paraprak të

ekspertizës së kërkuar duke informuar se i nevojitet informacion i mëtejshëm mungesa e të cilit e bënë të pamundur kryerjen e ekspertimit.

II.20. Me shkresën nr. 348/19 prot, datë 30.05.2025, Komisioni i është drejtuar autoritetit kontraktor, për paraqitjen e informacionit të kërkuar nga eksperti për vijim e ekspertizës nga ana tij.

II.21. Nëpërmjet shkresës nr.564/7 prot., datë 03.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/20 prot., datë 04.06.2025, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nga autoriteti kontraktor shkresa me objekt “*Kthim përgjigje*” me informacionin e kërkuar.

II.22. Me shkresën nr. 348/21 prot., datë 05.06.2025 Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertit Elidon Kallaverja, përgjigjet e pyetjeve që parashtroeshin në “*Raportin paraprak*” të dërguar prej tij për zgjidhje nga ana e tij, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.23. Në zbatim të vendimit nr. 457/2025, datë 09.04.2025 të KPP-së, me shkresën me objekt “*Raport ekspertimi*” protokolluar me tonën me nr. 348/22 prot., datë 09.06.2025, ekspertiza ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi, në të cilën ndër të tjera citohet si më poshtë vijon:

*“[...]Shitjellim I raportit:*

*V.K.M Nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” (I Korrigjuar) eshte nje manual i cili vlen per llogaritjen e pagesave per te githa sherbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit te kryera nga arkitektet dhe inxhinieret (porosi marres) te financuara me fonde publike te perfshira ne listen e ketij manuali. Ne varesi/ te tipit te punimeve he klasifikimi i pagesave eshte i ndryshem bazuar ne disa parametra te cilat klasifikohen sipas grupeve tarifore ne varesi te shkalles se veshtiresise ne projektim/mbikqyrie apo kolaudim. Tarifa per sherbimet duhet te jete nje vlere ndermjet tarifave minimale dhe maksimale te percaktuar ne kete manual ne perputhje me ligin e prokurimit publik. Per llogarijen e fondit limit minimal dhe maximal sipas V.K.M 354 date 11.05. 2016 duhet ti referohem kostove te llogaritshme te punimeve ndertimore gene rastin tone kostot Ndertim-Montim Jane: 937, 788, 493.28 leke me tvsh dhe klasifikimit te shkalles se veshtiresise sipas grupit tarifar referuar nga Autoriteti Kontraktor. Zgjedhja e grupit tarifar klasifikues eshte targer i Autoritetit Kontraktor ne bashkepunim me Studio Projektuese pasi per klasifikimin e punimeve ne nje nga pese grupet tarifore merren parasysh shume faktore, te shjelluara gjeresisht ne VKM dhe nuk eshte qellim objekt akt ekspertize.*

*Pas kerkeses nga ana jone per informacion shtese:*

***Mbi menyren e perllogaritjes se fondit limit nga Autoriteti Kontraktor ku te qartesohet:***

*1. Planifikimi i objektit sipas Kreut III te VKM 354 date 11.05.2016 (Çfare seksioni eshte klasifikuar ky objekt)*

*Nese i eshte referuar vetem Seksionit III "Vera Inxhinierike" apo i eshte referuar dhe Seksioneve te tjera te kesaj VKM.*

*2. Grupi trarifor te klasifikimit sipas seksionit qe i eshte referuar, dhe fondeve limit nese i eshte referuar me shume se nje tipologjie seksioni.*

*3. Ne fondin limit te kesaj procedure gjate perllogaritjes jane perfshire shumatoret e paisjeve apo vetem ana ndertimore.*

*Me e-mail informohemi per shkresen Nr. 56477 Prot. Dt.03.06.2025 dhe protokolluar ne KPP Nr. 348/20 Prot Dt.04.06.2025 ku nga Autoriteti Kontraktor i eshte kthyer pergjigje kerkesave per informacion.*

*Nga shkresa e derguar konstatoime:*

*1. Ka mosperputhje mes vleres se shpallur ne dokumentat standarte te tenderimit mbi fondin limit vene ne dispozicion dhe asaj te referuar nga Autoriteti Kontraktor Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizimeve*

*Vlera limit e tenderuar: 6,289, 100.00 leke Pa TVSH*

*Vlera limit e referuar: 6,319,088.00 leke Pa TVSH*

*Vlera e differences: 29,988 leke Pa TVSH*

***Sa siper konkludojme ne pergjigje te kerkesave nga KPP:***

*1. - A eshte perllogaritur fondi limit per proceduren e prokurimit object-ankimimi nga Autoriteti Kontraktor ne perputhje me VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te farifave per sherbimet ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim"?*

***Vlera e shpallur ne DST prej 6,289, 100.00 leke Pa TVSH eshte 29,988 leke me pak se perllogaritja e fondit maximal referuar nga AK.***

*2.- Sa eshte kufiri minimal he maksimal i sherbimit te supervizimit per procedure e prokurimit "Optimizimi i ujësjetllësiti te qytetit të Vorës dhe rrethinat" me fond limit 937.788, 493. 28 leke me tvsh referuar VKM Nr. 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tartfave per sherbimet ne planiikim territori projektin, mbikqyre dhe kolaudin"?*

*Pergjigja e pikes 2 eshte ezauruar me pergjigjen e pikes1.*

**Konkluzione:**

**1. Mosperputhja mes vleres se shpallur ne DST dhe asaj te perllogaritur nga AK perben kusht per anulimin e kesaj procedure dhe rishpalljen e saj sipas perllogaritjeve te vena ne dispozicion.**

**2. Diferenca e vleres se shpallur me ate te perllogaritur eshte e tille qe cenon garen mes operatoreve ekonomik Pjesmarres pasi Operatoret Ekonomik ne menyre qe vlera te jete**

**brenda limiteve te VKM Nr.354, i referohen ne perlllogaritjeve dhe fondit limit te shpallur**".

II.24. Me shkresën nr.348/23 prot, datë 09.06.2024, Komisioni i është drejtuar ekspertit, për paraqitjen e aktit të ekspertimit të plotë pas nuk ishin ezauruar të gjithë pyetjet e drejtuara për ekzpertizë prej tij.

II.25. Nëpërmjet shkresës nr. prot., datë 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/24 prot., datë 11.06.2025, është dërguar nëpërmjet postës elektronike [kpp\\_info@kpp.gov.al](mailto:kpp_info@kpp.gov.al) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, shkresa "Raport ekspertizë (plotësim)" e ekspertit Elidon Kallaverja, nënshkruar prej tij, në të cilën citohet si më poshtë vijon:

" [...] Në vijim te komunikimit, ne përgjigje te shkreses 348/23 Prot. Dt. 09.06.2025 ju informojmë sa më poshtë vijon:

Bazuar në V.K.M Nr 354 Dt. 11.05.2016 "Per miratimin e manualit te tarifave per sherbimet ne planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim" per objektin: "Optimizimi i ujesjellesit te qytetit te Vores dhe rrethinat" me fond limit 937,788,493.28 leke me TVSH (Ndertim+Montim) ose 781,490, 411.075 lek pa TVSH, vlerat minimale e maksimale per sherbimin e mbikyrjes se punimeve sipas "Grupit tarifar Ill te klasifikimit" ne seksionin "Vera inxhinierike" eshte:

**Fondi Limit: 781, 490,411.075 Pa TVSH x 3.5% sipas tabelës Grupi tarifar III = 27,352, 164.39 lekë Pa TVSH**

**Vlera e komplet sherbimit (Projektim+Mbikqyrje+ Kolaudim)**

**Vlera ne mbikqyrje Minimumi: 27,352, 164.39 leke x 20% = 5,470,432.88 leke Pa TVSH**

**Fond Limit: 781,490,411.075 Pa TVSH × 4% sipas tabelës Grupi tarifar III = 31,259,616.44 leke Pa TVSH**

**Vlera e komplet sherbimit (Projektim+Mbikqyrje+Kolaudim)**

**Vlera ne mbikqyrje Maximumi: 31,259,616.44 leke x 20% = 6,251,923.29 leke Pa TVSH**

**Konkluzione:**

**1. Sa siper vlera maksimale qe duhet te perlllogaritet fondi limit 6,251,923.29 leke Pa TVSH,**

**2. Sa siper vlera minimale qe duhet te behet klasifikimi i operatoreve si oferte e suksesshme 5,470,432.88 leke Pa TVSH.**

II.26. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK se: *“Ne si Operator ekonomik kemi paraqitur ofertën me vlerë minimale të lejuar sipas miratimit të manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimi të. Grupi III tarifor, pika C. dhe të argumentuar me analizën sipas llogaritjeve në vijim, prandaj kërkojmë rivlerësimin e ofertave dhe vlefshmërinë e ofertës të lejuar si më poshtë, i bashkëlidhur ne Formularin e Ankimimi”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në datë 09.04.2025 mori vendimin e ndërmjetëm nr. 457/2025, ku vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”*.

III.1.2. Me shkresën nr. 348/17 prot., datë 23.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertit Elidon Kallaverja, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e tij, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertit i janë parashtruar këto pyetje:

1. *A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
2. *Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat” me fond limit 937,788,493.28 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*

III.1.3. Në zbatim të vendimit nr. 457/2025, datë 09.04.2025 të KPP-së, me shkresën me objekt *“Raport ekspertimi”* protokolluar me tonën me nr.348/22 prot., datë 09.06.2025, eksperti ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi, *“Raport ekspertizë”*.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Komisioni konstaton, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “GB Civil Engineering” SHPK kanë të bëjnë përkatësisht me vlerën e ofertuar prej tyre duke kërkuar rivlerësimin e saj dhe vlefshmërinë e ofertës për të cilën janë skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me arsyen se rezulton që oferta ekonomike e paraqitur nuk është llogaritur në përputhje me VKM Nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, duke qenë se oferta ekonomike është nën kufirin minimal të përlogaritur nga Autoriteti kontraktor të vlerës minimale e maksimale të lejuar në kuptim të Nenit 7/1 te

kësaj VKM-je, kërkesë kjo e cila bazohet ne Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016., duke rezultuar nën vlerën minimale të lejuar, bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016. Sikundër pasqyruar më sipër, për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykoi të nevojshme, të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe të përllogarisë kufirin minimal dhe maksimal të shërbimit të supervizimit, për procedurën e prokurimit “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat”, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Referuar “Raport ekspertizës (plotësuese)” së ekspertit Elidon Kallaverja, me shkresën e datës 10.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 348/24 prot., datë 11.06.2025, ka rezultuar se:

“ [...] Në vijim të komunikimit, në përgjigje të shkresës 348/23 Prot. Dt. 09.06.2025 ju informojmë sa më poshtë vijon:

Bazuar në V.K.M Nr. 354 Dt. 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, për objektin: “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat” me fond limit 937,788,493.28 lekë me TVSH (Ndërtim+Montim) ose 781,490, 411.075 lekë pa TVSH, vlerat minimale e maksimale për shërbimin e mbikëqyrjes së punimeve sipas “Grupit tarifar III te klasifikimit” në seksionin “Vlera inxhinierike” është:

Fondi Limit: **781, 490,411.075 Pa TVSH** x 3.5% sipas tabelës Grupi tarifar III = 27,352, 164.39 lekë Pa TVSH.

Vlera e komplet shërbimit (Projektim+Mbikëqyrje+ Kolaudim)

Vlera në mbikëqyrje **Minimumi**: 27,352, 164.39 leke x 20% = **5,470,432.88 leke Pa TVSH**

Fond Limit: 781,490,411.075 Pa TVSH × 4% sipas tabelës Grupi tarifar III = 31,259,616.44 lekë Pa TVSH

Vlera e komplet shërbimit (Projektim+Mbikëqyrje+Kolaudim)

Vlera në mbikëqyrje **Maksimumi**: 31,259,616.44 leke x 20% = **6,251,923.29 lekë Pa TVSH**

### **Konkluzione:**

**1. Sa sipër vlera maksimale që duhet të përllogaritet fondi limit 6,251,923.29 lekë Pa TVSH,**

**2. Sa sipër vlera minimale që duhet të bëhet klasifikimi i operatorëve si ofertë e suksesshme 5,470,432.88 lekë Pa TVSH.**

Referuar dispozitës ligjore në *fushën e mbikëqyrjes*, konkretisht VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, KPP sqaron, se autoriteti kontraktor për përlogaritjen e fondit për shërbimet e parashikuara të kërkuara në dokumentet e tenderit dhe më tej për vlerësimin e ofertave të paraqitura, duhet të ketë në konsideratë hapat e parashikuar, në varësi të kategorisë dhe grupit tarifar si dhe fondit të procedurës së punës që është kërkuar për t’u realizuar ky shërbim, ku bën pjesë objekti i prokurimit.

Referuar “Raport ekspertizës” së ekspertit Elidon Kallaverja, ky i fundit ka konfirmuar se **KUFIRI MINIMAL** i shërbimit të supervizionit sipas përlogaritjes rezulton: **5,470,432.88 lekë Pa TVSH** për procedurën e prokurimit “Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat” me fond limit 937,788,493.28 lekë me TVSH (Ndërtim+Montim) ose 781,490,411.075 lekë pa TVSH, referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. KPP konstaton, se operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, ka paraqitur në SPE Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, ku ka deklaruar se çmimi i ofertës pa TVSH është **5,470,432.88** lekë pa TVSH, vlerë e cila është sa minimumi i lejuar për shërbimin e supervizionit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, referuar “Raport ekspertizës” së ekspertit, raport i cili është hartuar referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Sa më sipër konstatuar, Komisioni vlerëson, se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK në vlerën 5,470,432.88 lekë pa TVSH është e rregullt, e për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “G B Civil Engineering” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “G B Civil Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-

34934-12-30-2024, me objekt: *Supervizion punimesh për objektin: "Optimizimi i ujësjellësit të qytetit të Vorës dhe rrethinat"*, me fond limit 6,289,100.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 10.01.2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve.

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatori ekonomik "G B Civil Engineering" SHPK duke e kualifikuar sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "G B Civil Engineering" SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

